



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL. Anr.240/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Hajriz Hoti, kryesues, Violeta Husaj Rugova dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Anisa Jashari, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega Viti, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 20.10.2025, merr këtë,

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa, parashtruar nga Anisa Jashari nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega Viti, ZL.Anr.240/2025, e datës 17.10.2025, e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive gjatë ditës së votimit për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me datën 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 17.10.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesë nga Anisa Jashari nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega Viti, e cila është dorëzuar në Postën e Kosovës me datë 14.10.2025, në të cilën thekson se komisioneri votën e pavlefshme e shpall të vlefshme, subjekti ka qenë i votuar ndërsa asambleisti jo, votën e ka marrë numri 2 (PDK).

KQZ në përgjigjen në ankesë thekson se lidhur me pretendimet e palës ankuese për ankesën dhe A.nr.240, ju njoftojmë se në kuptim të nenit 16 par.3 të Rregullores Zgjedhore Nr.12/2024, konstaton se votat konsiderohen të pavlefshme vetëm në rastet si në vijim: Votohet më shumë se një subjekt politik, nuk votohet asnjë subjekt politik, votohet vetëm kandidati e jo subjekti politik, dhe qëllimi i votuesit nuk është i qartë sipas procedurave të votimit dhe numërimit në vendvotim.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën dhe përgjigjen në ankesë dhe vëren se ankesa është e pabazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës, përgjigjes në ankesë të KQZ-së, vlerësoj se pretendimet në ankesën e Anisa Jashari nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës

(PDK), me seli në Prishtinë, dega Viti, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë se “Komisioneri votën e pavlefshme shpallë të vlefshme. Subjekti ka qenë i votuar ndërsa asambleisti jo, votën e ka marrë numri 2 (PDK)”, paneli nuk ka arritur që të vërtetoj se ka pasur shkelje apo parregullsi për të cilat pala ankuese pretendon me ankesën e tij, kjo pasi që paraqitësi i ankesës nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë provë dhe nuk ka arritur me ankesë të argumentoj pretendimet e tij se i mungojnë votat, ndërsa pretendime e theksuara më shumë janë supozime se sa thënie të dokumentuara në fakte dhe në prova konkrete. Paneli po ashtu edhe nga përgjigja e ofruar nga KQZ-ja shihet se nuk ka pasur asnjë nga parregullsitë për të cilat pretendohen me ankesë.

Andaj Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të përgjithësuara, të pa argumentuara dhe të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë, parashtuesja e ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj me asnjë provë të vetme se me këto veprime ka pasur shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhje apo të Rregullave Zgjedhore të KQZ-së.

Paneli, vlerësoi se ankesa është e pabazuar dhe e pa argumentuar, pasi që parashtuesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi si formularët e rezultateve të subjekteve politike dhe të kandidatëve, librin e votimit, deklaratat e KVV apo dokumente të tjera, apo mbështetjen-në pohimet të qytetarëve (votuesve) nuk është e argumentuar e me te cilën do të vërtetoheshin këto pretendime.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtuesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi te qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen përcaktohet se “Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nenin 117 paragrafi 3, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.240/2025 datë 20.10.2025



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.